

**Me rastin e Asamblesë së 12 të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në
Mitrovicë më 23 shtator 2010**

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë:

Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Gerrit-Marc Sprenger, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Caroline Charpentier, Charles Smith, Christine Lindemann-Proetel, Dragomir Yordanov, Esmā Erterzi, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gianfranco Gallo, Gunnar Oyhaugen, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Johanna Schokkenbroek, Jonathan Welford-Carroll, Karen Asphaug-Warg, Klaus Huner, Klaus Jung, Ingo Risch, Lars Dahlstedt, Nikolay Entchev, Richard Winkelhofer, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vitor Pardal.

Miratton Vendimin

Me 24 vota për dhe 3 abstenime, për miratimin e këtij Udhëzimi mbi Monitorimin, Udhëzimin dhe Këshillimin (MUK) për Gjyqtarët e EULEX-it.

Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it



UDHËRRËFYES PËR MONITORIM, UDHËZIM DHE KËSHILLIM (MUK) NGA GJYQTARËT E EULEXIT

**Miratuar nga Asambleja e Gjyqtarëve të BE-së më 23 shtator 2010, në Mitrovicë,
Kosovë**

INDEKSI

HYRJE	3
1. MONITORIMI	3
2. UDHËZIMI	3
3. Aktivitetet e Monitorimit dhe Udhëzimit	4
a. MU gjatë kryerjes së funksioneve ekzekutive	4
b. Takimet individuale në mes të gjyqtarëve	4
c. Takimet kolektive në mes të gjyqtarëve	5
d. Takimet me stafin tjetër të gjykatës	5
e. Rishikimi i lëndëve të gjykatës	5
f. Pjesëmarrjes në seancat gjyqësore	6
g. Asistimit në hulumtime	6
h. Asistimit në përpilimin e jurisprudencës	6
i. Asistimit në trajnime	6
j. Trajnime profesionale rajonale	6
k. Takimeve me Odën e Avokatëve të Kosovës	6
4. KËSHILLIMI	7
5. MUK PËR SISTEMIN E RAPORTIMIT	7
6. FAZA E TANISHME E MUK-ut	7

HYRJE

Me 23 tetor 2008, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka përcaktuar Udhëzimin e parë për Monitorim, Udhëzim dhe Këshillim (MUK) për Gjyqtarët e EULEX-it. Dokumenti përmbante definicionet e aktivitetëve të MUK-ut dhe ka propozuar udhëzime se si të bëhet MUK-u në praktikë.

6 muajt e parë të aktivitetëve të misionit ishin të fokusuara në vlerësimin, të pasuar nga 6 muajt të tjerë të dizajnit të projektit, të përfunduar me Katalogun e Veprimeve për Gjyqtarët. Katalogu i veprimeve përcakton qëllimet kyçe të MUK-ut. Prandaj, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka ndryshuar Udhëzimin më 23 shtator 2010.

1. MONITORIMI

Monitorimi nënkuptohet si vëzhgim profesional dhe vlerësim i sistemit gjyqësor për identifikimin e dobësive në administrimin e drejtësisë dhe zbatimin e Sundimit të Ligjit dhe kontradiktave me standardet Evropiane dhe praktikat më të mira.

Monitorimi nuk nënkupton ushtrimin e kontrollit individual apo ndonjë lloj tjetër mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave kosovare.

Në rast se një gjyqtar i EULEX-it vëren sjellje të keqe nga njëri prej kolegëve vendorë gjatë aktivitetit të monitorimit, kjo sjellje do të raportohet me kohë të mbikëqyrësi i EULEX-it dhe organet kompetente vendorë disiplinore dhe ndjekëse.

Monitorimi ka për qëllim vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm të efikasitetit të gjyqësorit në Kosovë gjatë aplikimit të parimit përkatës të drejtësisë dhe standardeve ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Veç kësaj, procesi i monitorimit nuk duhet të nënkuptohet si mundësi shtesë që palët e pakënaqura me rezultatin e lëndës së tyre të apelojnë kundër vendimit të gjykatës.

Gjatë ushtrimit të këtij qëllimi, gjykatësit e EULEX-it do të bashkë ndajnë përvojën dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar në monitorim të gjykatave siç janë KGJK-ja, OSBE-ja, USAID-i, KB-ja dhe Ombudspersoni.

2. UDHËZIMI

Nëse gjatë aktivitetit të monitorimit janë zbuluar zbrazëtira ose shkelje të përsëritura të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane ose dobësi në administrimin e drejtësisë dhe zbatimin e sundimit të ligjit, gjyqtarët e EULEX-it në përputhshmëri duhet të vazhdojnë aktivitetin e udhëzimit.

Udhëzimi është mbështetje joformale, e bazuar në besimin e ndërsjellë dhe respektin profesional, përmes shkëmbimit të përvojave, informacioneve, mendimeve dhe praktikave më të mira. Udhëzimi përfshin trajnimin, duke treguar se si duhet trajtuar një detyrë specifike, duke ndarë “teknikën e punës”, inkurajimin.

Teknikat e udhëzimit mund të jenë: trajnimi (ndarja e përvojave lidhur me kryerjen e detyrave specifike); këshillimi (ndihma gjykatësve vendorë në eksplorimin e pasojave të vendimeve potenciale); krijimi i rrjeteve (referimi i gjykatësve vendorë te kolegët tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë më shumë përvojë në lëndët ose çështjet e ngjashme); ofrimi i përvojave, informatave, mendimeve; sigurimi i burimeve përkatëse ligjore ose eseve doktrinarë apo jurisprudencës ndërkombëtare; propozimi i organizatave me përkrahje të aktorëve kompetent (siç është OSBE-ja, USAID-i, etj), programe trajnimi të shkurtra dhe të qarta.

Aktivitetet e udhëzimit duhet të bazohen në marrëdhënien e barazisë, “në mes të kolegëve”. Gjyqtarët e EULEX-it do të punojnë krah për krah me homologët e tyre vendorë dhe janë të integruar në një sistem gjyqësor vendor.

3. AKTIVITETET E MONITORIMIT DHE UDHËZIMIT

Aktivitetet në vazhdim të monitorimit dhe udhëzimit janë vetëm sugjerime:

a. Monitorimi dhe Udhëzimi gjatë kryerjes së funksioneve ekzekutive

Kryerja e funksioneve ekzekutive bart një potencial të mirë të zhvillimit të monitorimit dhe udhëzimit. Gjatë bashkëveprimit me gjyqtarët vendorë dhe stafin e gjykatës, personeli i NjGjE-së mund të monitorojë dhe udhëzojë pa u dukur të bezdisshëm apo mbikëqyrës, por më parë në një mënyrë interaktive.

b. Takimet individuale në mes të gjyqtarëve

Do të mund të ishte një strategji e mundshme e ekipit që t’i caktohen homologët vendor udhëzuesve ndërkombëtar në mënyrë që të mundësohet qasje personale në problemet e punës individuale dhe aktivitetet pasuese të monitorimit dhe udhëzimit, si mjet adekuat në baza kolegë-kolegë.

Takimet nuk duhet të mbahen si intervista të strukturuar dhe formale por ato duhet të jenë më shumë si biseda dhe diskutime joformale në mes të kolegëve. Shfrytëzimi i qasjes së listës kontrolluese mund të jetë i dobishëm për marrjen e shpejt të shënimeve lidhur me numrat ose statistikën ose emrat që mund të harrohen lehtë.

Sa i përket monitorimit, gjatë takimeve mund të mblidhen informatat për një numër të çështjeve, siç janë:

- Sistemi për caktimin e lëndëve (SMIL);
- Sistemi për pakësimin e lëndëve të papërfunduara;

- Shpërndarja e punës;
- Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Qasja në gjykatë,
- Mungesa e korrupsionit dhe diskriminimit;
- Incidentet e kërcënimeve;
- Incidentet e ndërhyrjeve të jashtme
- Paraburgimi (i seancës paraprake) dhe masat alternative
- Respektimi i kohës së arsyeshme për të marrë vendime;
- Ekzekutimi apo zbatimi i vendimeve gjyqësore, dënimeve me burgim dhe gjobave;
- Hetimet në vazhdim ndaj të njëjtit të dyshuar/akuzuar në një gjykatë tjetër të qarkut.
- Lëndët civile që kanë të bëjnë me pronën
- Numri i të ashtuquajturave “lëndë të pezulluara”.

Sa i përket udhëzimit, një takim është aktiviteti udhëzimi, ku gjyqtari i EULEX-it siguron mendime profesionale dhe ofron sugjerime për forcimin e praktikave më të mira.

Qasja e bazuar në lëndë mund të jetë e rekomandueshme duke pyetur gjyqtarin kosovar që të shoh në një apo më tepër dosje që ai apo ajo konsideron të jetë më i ndjeshëm apo kompleks. Kjo do t'i mundësonte gjyqtarit të EULEX-it që të sjell diskutimin në një nivel më praktik me përfshirjen e mundshme të gjyqtarit të EULEX-it në zgjidhjen e problemeve të lidhura me lëndët specifike.

Gjatë takimeve, gjyqtarët e EULEX-it duhet gjithmonë ta kenë parasysh rrezikun për përjashtim posaçërisht gjatë fazës së procedurës paraprake. Ato lëndë duhet të trajtohen me kujdes të posaçëm duke iu shmangur intervenimeve formale në lëndë dhe mbajtjes së nivelit të udhëzimit në nivel shumë joformal, me një ekspozim sa më vogël të mundshëm.

c. Takimet kolektive në mes të gjyqtarëve

Problemet specifike të gjykatës përkatëse ose çështjet tematike mund të diskutohen në një kolegji të zgjeruar.

Do të ishte e dobishme nëse i bashkohemi takimeve javore të gjyqtarëve vendor.

d. Takimet me personelin tjetër të gjykatës

NjGjE mund të takohet me personelin e gjykatës. Zyrtarët ligjor të EULEX-it duhet ta përqendrojnë vëmendjen e tyre posaçërisht në stafin e shkrimores.

e. Rishikimi i lëndëve të gjykatës

Gjyqtarët e EULEX-it mund të përzgjedhin lëndët (penale apo civile) nga Gjykata dhe t'i kontrollojnë këto lëndë lidhur me:

- Arsyet e caktimit të tyre/ praktikën;
- Vonesat në procedimin e tyre;
- Referimet;
- Regjistrimin në SMIL;
- Respektimin e ligjit;
- Respektimin e praktikave më të mira evropiane;
- Respektimin e rekomandimeve të EULEX-it;

Dhe diskutimi i gjetjeve me gjyqtarët vendorë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

f. Pjesëmarrja në seanca gjyqësore

Stafi i NjGjE-së (Njesisë së Gjyqtarëve të EULEX-it) mund të merr pjesë në seancat gjyqësore. Rekomandohet që pjesëmarrja të aranzhohet paraprakisht me gjyqtarin vendor me qëllim të shmangies së vizitave të papritura, dhe me qëllim që gjyqtari vendor të mos ndjehet i inspektuar dhe i vëzhguar me praninë e EULEX-it.

g. Asistimi në hulumtime

Stafi i NjGjE-së i ndihmon gjyqtarët vendorë në hulumtimet në fushën juridike dhe u asiston atyre që të kenë qasje në literaturën që ka të bëjë me konventat apo standardet ndërkombëtare.

h. Asistimi në përpilimin e jurisprudencës

Gjyqtarët e EULEX-it mund të mbështesin gjyqësorin vendor në përgatitjen e komentareve të ligjeve dhe të kodeve si dhe në përgatitjen e një baze kolektive të të dhënave të jurisprudencës.

i. Asistimi në trajnim

Gjyqtarët e EULEX-it mund të kontribuojnë përmes aktiviteteve të tyre të udhëzimit, që trajnimet përkatëse të organizohen nga aktorët kompetentë (siç janë KGjK, IGjK, OSBE, USAID, etj).

j. Trajnimet profesionale rajonale

Në bazë të problemeve juridike tashmë përgjithësisht të hetuara gjatë punës së të mentoruarve, dhe me qëllim të shmangies së mospajtimeve dhe punës së dyfishtë gjatë aktivitetit të mentorimit (udhëzimit), mund të organizohen mbledhje të veçanta lidhur me çështjet e veçanta juridike në nivelin rajonal. Këto mbledhje do të organizoheshin nga ekipet rajonale, sipas modelit mbi “trajnimin e rregullt në punë” për stafin ndërkombëtar: me disa prezantime të shkurta nga stafi ndërkombëtar lidhur me çështjet e veçanta teknike dhe tematike me qasje interaktive, duke përfshirë të gjithë të mentoruarit rajonalë, në një trajnim të vetëm njëditor. Pjesëmarrja në këtë trajnim fuqishëm do të rekomandohej paraprakisht.

k. Takimet me Odën e Avokatëve të Kosovës

Kjo gjë do t’u mundësonte gjyqtarëve të EULEX-it që të njihen më mirë me problemet dhe me vështirësitë me të cilat përballen avokatët. Për më tepër, kjo do të tregonte edhe sfidat e mundshme që lidhen me marrëdhëniet në mes të gjyqtarëve dhe avokatëve kosovarë.

4. KËSHILLIMI

Po qe se monitorimi dhe udhëzimi (mentorimi) nuk arrijnë që të eliminojnë një problem të veçantë, në kuptimin që vazhdojnë edhe më tej shkeljet apo mosfunksionimet strukturore, hapi i fundit që ndërmerret nga gjyqtarët e EULEX-it është këshillimi.

Këshillat janë qëndrimet formale dhe zyrtare të marra në mënyrë kolektive nga gjyqtarët e EULEX-it përmes Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe të drejtuar nga organit përkatës kompetent. Këshillimi synon ofrimin e këshillave profesionale organit kompetent (KGjK-së, Kryetarëve të Gjykatave, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, etj) lidhur me çështje të caktuara të cilat dalin nga përvojat e monitorimit dhe udhëzimit.

Këshillat i drejtohen institucionit përkatës dhe jo homologëve individualë.

Këshillimi u ofron palëve me interes pasqyrën e nevojshme për të ndërhyrë në këtë fushë të veçantë të sistemit të drejtësisë i cili ka nevojë për përmirësime të përgjithshme dhe strukturore të tërë sistemit gjyqësor të cilat nuk mund të kryhen përmes aktivitetit të udhëzimit të gjyqtarëve të EULEX-it.

5. SISTEMI RAPORTUES I MUK-ut

Gjyqtarët e EULEX-it këshillohen që të raportojnë mbi progresin e aktiviteteve të MUK-ut, në bazë të kësaj procedure:

- 1) Gjyqtarët e EULEX-it kontrollojnë afatet kohore dhe prioritetet e Katalogut të Veprimeve të MUK-ut si dhe afatet / planin përkatës të punës.
- 2) Gjyqtarët e EULEX-it raportojnë një herë në muaj lidhur me gjetjet lidhur me secilin objektiv në Sistemin Informativ të Zyrës së Programit, përmes zyrtarit të caktuar raportues në kuadër të secilit ekip të GjQ të EULEX-it.

6. Faza e tanishme e MUK-ut

Faza II e MUK-ut ka filluar që nga nëntori 2009 dhe ajo paraqet një program i cili zgjat 18 muaj. NjGjE-ja ka përcaktuar 10 Objektiva në katalogun e veprimeve të MUK-ut. Përveç kësaj, ekziston edhe dokumenti i orarit të veprimeve të MUK-ut i cili rregullon afatet e ndryshme të objektivave.

Sipas objektivit të përcaktuar, NjGjE-ja duhet që të përqendrohet në 18 muajt e ardhshëm, duke filluar që nga nëntori 2009, në këto 10 pika gjatë aktiviteteve të tyre të MUK-ut:

1. Pavarësia e gjyqësorit
2. SMIL
3. Sistemi i caktimit të lëndëve
4. Përmirësimi i Gjyqësorit të Kosovës nëpër gjykata
5. Lëndët e rënda penale
6. Urdhër-arrestet shtetërore/ ndërkombëtare
7. Paraburgimi
8. Shkeljet gjyqësore

9. Vendimi i gjykatës civile
10. Lëndët e pezulluara dhe lëndët pronësore

Duke filluar që nga shtatori 2010, këto 10 pika të përmendura më lart do të ndahen më tej në këto katër Objektiva si më poshtë:

- 1 Objektivi 1: Menaxhimi i gjykatës
- 2 Objektivi 2: Pavarësia e gjyqësorit
- 3 Objektivi 3: MUK-u lidhur me lëndët penale
- 4 Objektivi 4: MUK-u lidhur me lëndët civile

Aneks: Lista e rekomandimeve dhe e këshillave të NjGjE-së duke filluar që nga gushti 2010:

I. Rekomandimet e bëra nga Zyra e Programit të EULEX-it, korrik 2009

Në korrik 2009, ka përfunduar vlerësimi i parë i Gjyqësorit të Kosovës dhe i njëjti është analizuar në raportin gjashtëmuor të Zyrës së Programit, në kuadër të të cilit janë 11 rekomandime që kanë të bëjnë me Gjyqësorin e Kosovës dhe 4 prej tyre u drejtohen drejtpërdrejt Gjyqtarëve të Kosovës:

• Rekomandimi JC/2/2009 i EULEX-it

Objektivi: KGjK-ja dhe gjyqtarët kosovarë

(1) të shfuqizohet baza ligjore për rigjytime, (2) KGjK-ja të lëshojë udhëzimin që Gjyqtarët e shkallës së dytë u referohen lëndëve civile duke paraqitur arsyetimin përmbajtjesor, (3) Gjyqtarët e EULEX-it të përcaktojnë një model të këshillimeve të rregullta ndërmjet gjyqtarëve civilë të EULEX-it dhe atyre kosovarë për vendosjen e bazës për diskutime ligjore, në të cilat do të përfshihej edhe çështja e rigjytimeve.

• Rekomandimi JC/3/2009 i EULEX-it

Objektivi: KGjK-ja, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), dhe Kryetarët e Gjykatave

- 2) Përmirësimi i shkallës së re-integrimit dhe përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në Sistemin e Drejtësisë së Kosovës
- 3) Sigurimi i përkushtimit të lartë për politikën e barazisë gjinore

• Rekomandimi JC/9/2009 i EULEX-it

Objektivi: KGjK-ja, Kryetarët e Gjykatave, Gjyqtarët e Kosovës dhe Asociacioni i Gjyqtarëve të Kosovës

Të përmirësohet qasja e integruar e orientimit në shërbime të KGjK-së ndaj Gjykatave të Kosovës

- **Rekomandimi JC/11/2009 i EULEX-it**

Objektivi: KGjK-ja, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Gjyqtarët e Kosovës dhe Prokurorët e Kosovës

Përmirësimi i zbatimit efektiv të masave mbrojtëse për dëshmitarët në krimet që përfshijnë dëshmitarë të rrezikuar dhe krime të rënda

II. Këshillat e Gjyqtarëve të EULEX-it

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka miratuar gjer më tani shtatë këshilla të cilat i drejtohen Këshillit Gjyqësor të Kosovës (3) si dhe Gjykatave (4), të cilat i janë prezantuar Gjyqësorit të Kosovës në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

- 23 tetor 2008: (e miratuar gjatë Asamblesë së dytë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për KGjK-në përkitazi me sistemin për caktimin e lëndëve në gjykatat e Kosovës

- 10 gusht 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së gjashtë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për KGjK-në përkitazi me shpërndarjen e Gazetës Zyrtare nëpër të gjitha Gjykatat e Kosovës

- 23 shtator 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së shtatë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për Gjykatat e Kosovës lidhur me shqyrtimin lëndëve përmbarese pas ankesës

- 23 shtator 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së shtatë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për gjykatat lidhur me qasjen në gjykata

- 9 dhjetor 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për gjykatat e Kosovës lidhur me krijimin e sistemit të regjistrimit, vlerësimit dhe dorëzimit të ankesave në lëndët penale në pajtim me Nenet 407, 408, dhe 409, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

- 9 dhjetor 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për gjykatat e Kosovës lidhur me krijimin e sistemit për caktimin e drejtë të lëndëve

- 9 dhjetor 2009: (e miratuar gjatë Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të BE-së). Këshillë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës lidhur me mjetet e ndryshme për forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së Gjyqësorit.